

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit: 02 K04 / 118
Nr. i ftoqevs (broj stranica) No. pages: 7
Data Datum Date: 24.02.2025
PRISHTINË/A

Prot. No.: 387-1/2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Drenasit
	Bekim Lestrani , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela , Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Avni Zogiani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Arton Ahmeti , Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli , Zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 108/2025
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Shqiptar Ibra Zyrtar i Lartë Ligjor, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Drenasit
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,

I nderuari Kryesues z. Lestrani,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të

kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimin 02 Nr.400/01-4780 për ndryshimin – plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba</i>
<i>I miratuar më datë 31.01.2025</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 31.01.2025</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 06.02.2025</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “**Ministria**”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:



1. Komuna e Drenasit, me anë të aktit administrativ komunal synon të ndryshimin/plotësimin e rregullores Nr.12 Nr.400/03-62198 të datës 28.12.2023.
2. Në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e aktit administrativ komunal, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si “**LMFPP**”), Ligjin Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe Ligjin Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025.
3. Parimi i përgjithshëm i mishëruar në LMFPP është se çdo organizatë buxhetore, në shpenzim të parasë publike, duhet të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore të LMFPP-së, sikurse përcaktohet në nenin 3 të LMFPP-së.
4. Në përmbajtje të LMFPP-së, paratë publike përkufizohen si pasuri financiare ose para të cilat pranohen, janë nën përkujdesjen, mbahen në mirëbesim ose janë nën kontrollin e ndër tjerash, organizatave buxhetore.
5. Ndërsa, në kontekst të shpenzimit të parasë publike, neni 17 i LMFPP-së përcakton se shpenzimi i parave publike nga organizatat buxhetore mund të bëhet vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe nga *fondet e ndara dhe të alokuara* [theks i shtuar].

6. Po ashtu, në kontekst të aktit në fjalë duhet marrë parasysh dhe Ligji Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Bazuar në nenet 10-22 të këtij Ligji, Komunave ju lejohet marrja e vendimeve të tilla lidhur me realizimin e të hyrave vetanake komunale për vitin 2025 konform projeksioneve të parashikuara me Ligjin për ndarjet Buxhetore
7. Rrjedhimisht, për aq sa përcillen aktet e cekura më lartë, **akti administrativ i Komunës së Drenasit është në përputhje me legjislacionin në fuqi**, dhe i konfirmohet ligjshmëria.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Glllogocit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmbës:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbil Haxemi, Drejtor i Departamentit Ligjor	Datë: 05.02.2025 Nr.43-835/10
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të për përcjelljen e Komunave 30.01.2025 aktit në Ministri të Linjës 2. Zyrtari përgjegjës Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të për hartimin e Komunave 30.01.2025 shkresës përcjellëse	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për MEPT	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, Vendimin 02Nr.400/01-4780 për ndryshimin-plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02Nr.400/01-4780 për ndryshimin-plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

I miratuar më datë: 31.01.2025.

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.01.2025.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/03-4380 dt. 31.01/ 2025

Nr. 400/03-4380	
Data: 31.01.2025	
Niveli: VI- 43-85 / 10	

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, ("Gaz. Zyrt. e Republikës së Kosovës"), Dispozitivave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049 si dhe në bazë të Ligjit Nr. 08/L-257 (Për Administratën e Procedurave Tatimore) nenit 5 pikë 6 dhe dispozitivit tjetër si dhe Ligjit Nr. 08/L-262 Kapitulli XXIV Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullit të mbajtur më datë: 31.01.2025, miratoi këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA,
NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12 Nr.400/03-62198 të dt. 28.12.2023.

Neni 2

Ndryshohet Neni – Pika - 13.1.1 Bizneset do të ngarkohen sipas kodit primar të ushtrimit të veprimtarisë.

Ndryshohet Neni – Pika - 13.2.2 Bizneset elctituese dhe ato fillestare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre nga sektori A lirohen nga taksa në afatë të pacaktuar, përjashtimisht kodovë të parapara në ngarkesë.

Ndryshohet Neni – Pika - 13.2.4 Bizneset të cilat nuk janë duke ushtruar veprimtarinë lirohen nga taksa bazuar në regjistrin e veçantë të tatimpaguesëve joaktiv (pasive) të dërguar nga ATK/ARK. Regjistri i siguruar do të zbatohet për bizneset të sllët nuk kanë qonë aktive nuk kanë ushtruar veprimtarinë gjatë vitit 2024-e tutje.

Ndryshohet: Neni – Pika - 13.2.6 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik faturmën do ta bëjë deri në 30 shtator të vitit fiskal.

Ndryshohet: Neni – Pika - 13.2.7 Subjektet ekonomike faturën e caktuar sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje do ta paguajnë në afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit në të kundërtën lënda do të procedohet për inkasim të detyrueshëm përmes iniciimit të procedurës përmbarimore.

Ndryshohet: Neni – Pika - 13.2.8 Subjektet ekonomike faturën e prapuar brenda 30 ditësh mund ta kontestojnë me që të ankesës Drejtuar Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.

Hiqet: Neni – Pika 13.2.9.

Ndryshimet: Neni – Pika - 13.2.11 Në rastet që bizneset nuk marrin faturat, ato janë të obliguara të interesohen për obligimet e tyre ndaj Komunesë, pra të vizitojnë zyrën e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik pranë Komunesë së Drenasit.

Shtohet: Biznaset të cilat ushtrojnë veprimtarinë ngarkohen me këto vlera: Kodet: 1106 me vlerë 1,000.00 €, 4673 me vlerë 300.00 €, 5812 me vlerë 50.00 €, 6010 me vlerë 150.00 €, 7734 me vlerë 150.00 €, 7735 me vlerë 150.00 €.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunesë.



i Kuvendit të Komunesë

Beqim Lestani

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkrahëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

ARSYETIM

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-257 (Për Administrimin e Procedurave Tatimore), Nr. 08/L-257 (Për Administrimin e Procedurave Tatimore) nën 5 pikë 6 dhe dispozitat tjera të Ligjit NR. 08/L-262 Kapitulli XXIV Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmblimtare si dhe rregullimin e procedurave rreth aplikimit të nenit 13 të

rregullores, kërkohet nga ana e kryetarit të komunës që të bëjë plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12 Nr.400/03-62198 të dt.28.12.2023.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



01.Nr 400/01-338.5 dt. 21.04.2025

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pikë (h) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunes së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gaz. Zyrt. e Republikës së Kosovës"), Dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049 si dhe në bazë të Ligjit Nr. 08/L-257 (Për Administrimin e Procedurave-Talimore) nenit 5 pikë 6 dhe dispozitatë tjera si dhe LIGJIT NR. 08/L-262 Kapitulli XXIV Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbërëse, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën 27.07.2023 të aprovoj:

**PROPOZIM VENDIM
PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, TARIFA,
NGARKESA DHE GJOBA**

Neni 1

Me këtë Vendim, miratohet Plotësimi ndryshimi i Rregullores Nr. 12 Nr.400/03-62198 të dt. 28.12.2023.

Neni 2

Ndryshohet Neni – Pika - 13.1.1 Bizneset do të ngarkohen sipas kodit primar të ushtrimit të veprimtarisë.

Ndryshohet Neni – Pika - 13.2.2 Bizneset ekzistuese dhe ato fillestare që ushtrjnë veprimtaritë e tyre nga sektori A llohen nga taksat në afatë të pacaktuar, përjashtimisht kodeve të parapara në ngarkesë.

Ndryshohet Neni – Pika - 13.2.4 Bizneset të cilat nuk janë duka ushtruar veprimtarinë llohen nga taksat bazuar në regjistrin e veqantë të pajmuesësive joaktiv (pasive) të dërguar nga ATK/ARK. Regjistri i siguruar do të zbatohet për bizneset të silet nuk kanë qenë aktive nuk kanë ushtruar veprimtarinë gjatë vitit 2024 e tutje.

Ndryshohet: Neni – Pika - 13.2.6 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik fatumimin do ta bëjë deri më 30 shtator të vitit fiskal.

Ndryshohet: Neni – Pika - 13.2.7 Subjektet ekonomike fatumimin e caktuar sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje do ta paguajnë në afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit në të kundërtën lenda do të procedohet për inkasim të detyrueshëm përmes iniciimit të procedurës përbarimora.

[Signature]

Ndryshohet: Neni - Pika - 13.2.8 Subjektet ekonomike faturën e pranuor brenda 30 ditësh mund ta kontestojnë me anë të ankesës Drejtuar Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.

Hiqet: Neni - Pika 13.2.9.

Ndryshohet: Neni - Pika - 13.2.11 Në rastet që bizneset nuk marrin faturat, ato janë të obliguara të interesohen për obligimet e tyre ndaj komunës, për ta vizituar zyrën e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik pranë Komunës së Drenautit.

Shtohet: Bizneset të cilat ushtrajn veprimtarinë ngarkohen me këto vlera: Kodet: 1106 me vlerë 1,000.00 €, 4673 me vlerë 300.00 €, 5812 me vlerë 50.00 €, 6010 me vlerë 150.00 €, 7734 me vlerë 150.00 €, 7735 me vlerë 150.00 €.

Neni 3

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga data regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.



ARSYETIM

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-257 (Për Administrimin e Procedurave Tatimore), Nr. 08/L-257 (Për Administrimin e Procedurave Tatimore) nën 5 pikë 6 dhe dispozitat tjera si dhe LIGJIT NR: 08/L-262 Kapitulli XXIV Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbërëse si dhe rregullimin e procedurave nën aplikimit të nenit 13 të

rregullores, kërkohet nga ana e kryetarit të komitës që të bëjë plotësim Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 12 Nr.400/03-62198 të dt. 28.12.2023.

